

Në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 3, neni 8 paragrafi 1 alineja 6, neni 8-a paragrafi 1 alineja 2, 8-b dhe 8-v të Ligjit të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/06, 142/08, 148/09, 69/13, 120/13, 148/13, 41/14, 30/16 dhe 64/18), neni 26 dhe neni 27 paragrafi 4, neni 53 dhe neni 54, paragrafi 4 të Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat fillore dhe të mesme ("Gazeta Zyrtare e RMV", nr. 161/19), neni 2 i Rregullores për formularin e aplikimit për pjesëmarrje në shpallje publike për përzgjedhjen dhe akreditimin e programeve për trajnime dhe ofertues të shërbimeve për aftësimin profesional të kuadrit edukativo-arsimor në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 96/21), Plani vjetor i punës së Byrosë për vitin 2026 nr. 01-160/2 nga 27.01.2026, Programi për aftësim profesional të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme për vitin 2026 ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 29/26, prej 12.02.2026), dhe Programi për trajnime për zhvillimin profesional të bashkëpunëtorëve profesionalë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 30/26, e datës 13.02.2026), i miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, neni 2 paragrafi 1 pika 2 dhe paragrafi 2, si dhe neni 3 i Rregullores për përzgjedhjen dhe akreditimin e programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për zhvillim profesional të kuadrit edukativo-arsimor (mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë) në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut nr. 01-333/5, më datë 22.04.2025, Byroja e Zhvillimit të Arsimit publikon

SHPALLJE PUBLIKE

për përzgjedhjen dhe akreditimin e programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për zhvillim profesional të kuadrit edukativo-arsimor për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë në shkollat e mesme

Byroja e Zhvillimit të Arsimit bën shpallje publike për akreditimin e programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për zhvillim profesional të kuadrit edukativo-arsimor (mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë) në shkollat e mesme për temat në vijim:

Mësimdhënës

- Përdorimi i mjeteve të inteligjencës artificiale në mësimdhënie
- Zhvillimi i të menduarit kritik dhe analitik përmes leximit me kuptim – zbatimi i strategjive për analizë, interpretim dhe vlerësim të llojeve të ndryshme të teksteve në mësimdhënie
- Vlerësimi formativ dhe sumativ dhe dhënia e një informacioni kthyes cilësor, në kohë dhe konstruktiv për nxënësit
- Zhvillimi i aftësive digjitale dhe siguria kibernetike të nxënësit përmes përdorimit të sigurt, të përgjegjshëm dhe etik të teknologjive digjitale

Bashkëpunëtorë profesionalë

- Parandalimi dhe ndërhyrja në sjelljet e rrezikshme dhe problematike
- Trajnim i avancuar për metoda, teknika dhe instrumente për këshillim dhe orientim në karrierë
- Hulumtimi veprues si bazë për avancimin e punës edukativo-arsimore

- Zhvillimi i një mjedisi shkollor pozitiv, të sigurt dhe gjithëpërfshirës

Ofruesit e interesuar duhet të hartojnë dhe të dorëzojnë program për realizimin e trajnimit në kohëzgjatje prej 8 orësh, të organizuar në një ditë ose në dy ditë nga 4 orë, për mësimdhënës/bashkëpunëtorë profesionalë nga shkollat e mesme për temat e lartpërmendura, si dhe versionin Katalog të programit.

Kusht për pjesëmarrje në procedurën për përzgjedhjen dhe akreditimin e programeve të trajnimit dhe të ofruesve të shërbimeve për zhvillim profesional të kuadrit edukativo-arsimor (mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë) është përmbushja e kriterëve, për dëshmimin e të cilave kërkohen dokumentet në vijim:

1. Dokument për veprimtari të regjistruar, i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
2. Gjendje aktuale e lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
3. Bilanci i gjendjes dhe bilanci i suksesit, të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
4. Vërtetim se nuk është hapur procedurë falimentimi, i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
5. Vërtetim se nuk është hapur procedurë likuidimi nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
6. Vërtetim për taksat, kontributet dhe detyrimet e tjera publike të paguara, i lëshuar nga Drejtoria e të Ardhurave Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
7. Vërtetim i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga Regjistri i dënimeve për veprat penale të personave juridikë, se nuk i është shqiptuar dënim plotësues – ndalim i përkohshëm ose i përhershëm për ushtrimin e një veprimtarie të caktuar.
8. Vërtetim se me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar sanksion kundërvajtës me ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës, përkatësisht ndalim i përkohshëm për ushtrimin e një veprimtarie të caktuar, i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.
9. Vërtetim i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga Regjistri i dënimeve për veprat penale të personave juridikë, se nuk i është shqiptuar dënim plotësues – ndalim për pjesëmarrje në procedura të thirrjeve publike, dhënie të kontratave për furnizime publike dhe kontrata për partneritet publiko-privat.
10. Deklaratë se ka përvojë në realizimin e trajnimeve për zhvillim profesional, me informata më të detajuara, si dëshmi se ka realizuar së paku tre trajnime për mësimdhënës/bashkëpunëtorë profesionalë në arsimin formal në tema të ndryshme gjatë pesë viteve të fundit, duke llogaritur deri në ditën e publikimit të shpalljes, e verifikuar dhe e nënshkruar nga personi i autorizuar i ofruesit, e mbështetur me dëshmi (kontratë, vërtetim etj.).
11. Deklaratë nga ofruesi se disponon me hapësira të pajisura në mënyrë adekuate në të cilat do të realizohen trajnimet, me mjete mësimore për realizimin bashkëkohor të trajnimeve, me kontratë të bashkangjitur.
12. Listë dhe biografi (CV) me së paku 10 trajnerë në nivel rajonal, përkatësisht së paku 30 trajnerë në nivel shtetëror për fushën përkatëse, të cilët:
 - kanë së paku shkallën VII/1 të arsimit, përkatësisht 240 kredi, gjë që dëshmohet me dorëzimin e kopjes së diplomës ose vërtetimit për përfundimin e arsimit dhe kanë realizuar së paku 2 (dy) trajnime nga fusha përkatëse, gjë që dëshmohet me dorëzimin e vërtetimit origjinal ose

rekomandimit për trajnimet e realizuara, të lëshuar nga institucioni/kompania për të cilën është kryer shërbimi, ose

- janë ligjërues në së paku një (1) program studimor nga fusha përkatëse, gjë që dëshmohet me dorëzimin e një vërtetimi origjinal të lëshuar nga institucioni për të cilin kryhet shërbimi, përkatësisht në të cilin janë të punësuar dhe/ose të angazhuar.

13. deklaratë nga trajnerët se pajtohen të realizojnë trajnimet konkrete.

Me dokumentin nga pika 1, ofruesi i shërbimeve dëshmon se është i regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së paku pesë vite para datës së publikimit të thirrjes publike.

Me dokumentin nga pika 3, ofruesi i shërbimeve dëshmon se ka të ardhura minimale të përgjithshme në shumë prej 3.000.000 denarësh në tre vitet e fundit.

Kriteret e përmendura më sipër janë eliminuese.

Personi zyrtar i autorizuar nga Byroja, i cili udhëheq procedurën, brenda tre ditëve nga dita e pranimit të aplikimit për pjesëmarrje nga ofruesi i interesuar, sipas detyrës zyrtare, duhet të kërkojë dokumentacionin nga pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 nga organi kompetent.

Dokumentet nga pikat 10, 11, 12 dhe 13 përgatiten, nënshkruhen, vulosen dhe dorëzohen nga personi përgjegjës i ofruesit.

Ofruesi duhet të dorëzojë një program për akreditimin e një teme konkrete nga thirrja publike, të përgatitur në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e thirrjes publike.

Ofruesi duhet të dorëzojë ofertë për çmimin për pjesëmarrës në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentacionin e thirrjes publike.

Kriteret për vlerësimin e ofertave të pranuar janë:

- Çmimi për mësimdhënës/bashkëpunëtor profesional – 30 pikë,
- Përmbajtja e programit të ofruar – 60 pikë,
- Monitorimi i efekteve të trajnimit – 10 pikë.

Trajnimet për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë do të zhvillohen në gjuhën maqedonase, shqipe dhe/ose turke. Nëse ofruesi nuk ka mundësi të sigurojë trajnerë që të zhvillojnë trajnimin në gjuhën turke, mund të sigurohet përkthim pas-pas në gjuhën turke.

Trajnimet do të realizohen në grupe me maksimum 30 pjesëmarrës. Realizimi i trajnimeve do të fillojë gjatë vitit 2026, sipas dinamikës së përcaktuar me kontratën me ofruesin e përzgjedhur.

Byroja e Zhvillimit të Arsimit merr Vendim për akreditimin e një programi trajnimi dhe ofruesi i shërbimeve, me vlefshmëri tre (3) vjet.

Byroja e Zhvillimit të Arsimit nënshkruan kontratë me ofruesin e përzgjedhur për realizimin e trajnimit/trajnimeve, në përputhje me numrin e mësimdhënësve/bashkëpunëtorëve profesionalë nga shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut që kanë zgjedhur temën. Me kontratë përcaktohen qartë fazat e realizimit dhe dinamikat e zhvillimit të trajnimeve.

Në varësi të mjeteve të disponueshme në buxhetin e Byrosë, realizimi i trajnimeve do të zhvillohet etapë-pas-etapë, gjatë periudhës së vlefshmërisë së Vendimit për akreditim.

Shpallja publike zgjat 20 ditë, duke përfshirë edhe ditën e publikimit.

Hapja publike e ofertave të pranuara do të mbahet në ambientet e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, rr. Rugjer Boshkoviq nr. 20, Shkup, më **30.03.2026 në orën 11:00**. Afati për dorëzimin e dokumentacionit në arkivin e Byrosë është më **30.03.2026 deri në orën 10:30**.

Aplikacionet me dokumentacion të paplotë ose të pavlefshëm, si dhe ato të dorëzuara jashtë afatit, nuk do të shqyrtohen.

Dokumentacioni i nevojshëm për pjesëmarrje në thirrjen publike mund të merret nga arkivi i Byrosë për Zhvillimin e Arsimit ose nga faqja zyrtare e Byrosë: www.bro.gov.mk.

Në hapjen publike të ofertave të pranuara mund të marrin pjesë përfaqësues të pjesëmarrësve të interesuar me autorizim të shkruar, i vulosur me nënshkrim dhe stampë nga personi përgjegjës.

Si ofrues të programeve të trajnimit dhe ofrues të shërbimeve për zhvillim profesional të kuadrit edukativo-arsimor të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë në shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut mund të paraqiten institucionet publike dhe private, shoqatat e qytetarëve dhe shoqëritë tregtare.

Ofruesit e shërbimeve mund të dorëzojnë aplikim të veçantë për pjesëmarrje ose ofertë të veçantë, ose mund të bashkohen dhe të formojnë një grup ofruesish për të dorëzuar së bashku një aplikim për pjesëmarrje ose një ofertë grupore.

Në thirrjen publike nuk mund të paraqitet as si ofrues shërbimesh dhe as si trajner i angazhuar, i punësuar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Byronë e Zhvillimit të Arsimit, Qendrën Shtetërore të Provimeve, Qendrën për Arsimin e të Rriturve, Qendrën për Zhvillimin e Arsimit Profesional, Inspektoratin Shtetëror të Arsimit dhe drejtor shkolle.

Ofruesit e interesuar mund të parashtrojnë të gjitha pyetjet lidhur me thirrjen publike në formë elektronike, së paku 3 ditë para hapjes publike të ofertave, në e-mailin: bro.macedonia@bro.gov.mk me shënimin:

”Për Komisionin për përzgjedhjen dhe akreditimin e programeve të trajnimit dhe ofruesve të shërbimeve për kuadrin edukativo-arsimor – mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë në shkollat e mesme.”

Byroja e Zhvillimit të Arsimit